



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr- 28/2008”, nenit 11, 15 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, konform, Vendimeve të Kuvendit Komunal në Suharekë të miratuar në vitin 2003, për ndarjen e shpërblimeve të cekura më poshtë, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

**Për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve
“Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori”**

Neni 1

Shpërblimi **“Emblema e artë”** i ndahet, *Jetullah Sali Kuçi* nga Suhareka (postmortum).

Neni 2

Shpërblimi **“Skënderbeu”** i ndahet dëshmorit: **1. Naser Avdyll Bytyçi nga Suhareka dhe ish veprimtarit për çështje kombëtare 2. Qazim Ramë Bllaca nga fshati Bllacë.**

Neni 3

Mirënjohja **“13 Qershori”** i ndahet këtyre të nominuarëve (postmortum): 1. Banush Vrella nga fshati Qadrak, 2. Osman Cikaqi nga fshati Doberdelan, 3. Bardhyl Gega nga fshati Studenqan, 4. Xhezair Maloku nga fshati Dubravë, 5. Rexh Buzhala nga fshati Budakovë, 6. Rrahman Hamzaj nga fshati Gjinoc, 7. Ali Hoxha nga fshati Budakovë, 8. Milit Gashi nga fshati Studenqan, 9. Milazim Sopa nga fshati Neperbisht, 10. Sami Salih Kuçi nga Suhareka, 11. Shaban Brahim Gashi nga fshati Savrovë, 12. Miftar Hamit Guraziu nga fshati Bllacë, 13. Xhevdet Berisha nga Suhareka 14. Shemsedin Sadik Gega nga fshati Studenqan, 15. Nuhi Veselaj nga fshati Reqan, 16. Halil Ajet Krasniqi nga fshati Maqitev, 17. Muharrem Nebi Kuçi nga Suhareka, 18. Osman Sylejman Voci nga fshati Samdraxhë dhe 19. Njësia Speciale e shtabit të përgjithshëm të UÇK-së Kompania-II në Budakovë.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI